

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PERMBARUES GJYQËSOR PRIVAT BESNIK DOKUSHI

Credins bank
03.09.2019
Prot. 45654

VENDIM

(Për caktimin e vlerës së sendit të paluajjtshëm dhe shpalljen e shitjes në ankanin e dytë)

Unë, Përmbaruesi Gjyqësor privat Besnik DOKUSHI, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1445Regj, datë 11.03.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vënë në ekzekutim Urdhëri i Ekzekutimit duke regjistruar në dosjen përbarimore, datë 27.03.2019 kërkesa e kreditorit Credins Bank sh.a ndaj debitorit Shoqëria "MEG" sh.pk në lidhje me Titullin Ekzekutiv Kontratë Kredie Nr.5283, Nr.13207Rep, Nr.3746Kol, datë 27.11.2014 të lidhur midis Bankës Credins sha në cilësinë e kredidhënësit Shoqëria "MEG" shpk me NIPT K93113001J në cilësinë e kredimarrësit dhe Ilir Kola në cilësinë e dorëzandësit. Me përmbushjen konform ligjit të të gjitha hapave të parashikuara dhe të kërkuara procedurale, si dhe me përfundimin e afatit të fundit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm parashikuar në nenin 567 të K.Pr.Civile

KONSTATOVA:

Se, debitori Shoqëria "MEG" sh.pk nuk i është përgjigjur detyrimit kundrejt kreditorit Banka Credins Sh.a, si dhe të gjitha njoftimeve të cilat i janë bërë me dije nga Përmbaruesi Gjyqësor.

Lidhur sa më sipër, referuar nenit 568, 570, dhe 577 të K.Pr.Civile, si edhe nenit 32 (pika b, c) të ligjit Nr.10 031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Privat" dhe Udhëzimit Nr.385 datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përbarimor privat"

VENDOSA:

1. Të shpall ankandin e dytë për shitjen e pasurisë së paluajjtshme të debitorit:

- Pasuria në regjistrin hipotekor nr.1,faqe 6 nr.27 ind datë 22.02.2014, ZK .1997 e llojit Kullotë me sip. 19 ha me adresë Bulgjer,Janjar, Sarandë në pronësi të Shoqërisë "Meg Shpk"me NIPT K93113001J.

Cmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 425,600Euro (katërqind e gjashtëqind) Euro

- Pasuria në regjistrin hipotekor nr.1,faqe 6 nr.28 ind datë 22.02.2014, ZK .1997 e llojit Kullotë me sip. 7 ha me adresë Gropa e Alikës,Janjar, Sarandë në pronësi të Shoqërisë "Meg Shpk"me NIPT K93113001J.

Cmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 156,800Euro (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) Euro

- Pasuria në regjistrin hipotekor nr.1,faqe 6 nr.29 ind datë 22.02.2014, ZK .1997 e llojit Kullotë me sip. 100 ha me adresë Komdovun Salikat,Janjar, Sarandë në pronësi të Shoqërisë "Meg Shpk"me NIPT K93113001J.

Cmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 1,680,000 Euro (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) Euro

2. Ankandi do të qendrojë i publikuar nga data 28.08.2019 deri në datë 27.09.2019 dhe zhvillohet në këtë datë në përfundim të orarit zyrtar (ora 16:00).

3. Secili ofrues duhet të depozitojë bashkë me kërkesën për pjesmarrjen në ankand edhe garancinë prej 10% të cmimit fillestar në llogarinë bankare të Personit Fizik Besnik Dokushi pranë "Credins Bank " sh.a me nr. Llogarisë 0000856981 dhe IBAN AL61 2121 1016 0000 0000 0085 698.

4. Publikimi i këtij ankandi kryhet konform nenit 568 të K.Pr.Civile.

6. Tarifa për organizimin dhe shitjen e sendit në ankand sipas Udhëzimit Nr.385/7 datë 28.06.2017 është e barabartë me shumëb e 2 pagave bazë minimale mujore.

5. Ky vendim i komunikohet palëve të cilët kundër tij kanë të drejtën e ankandit brenda 5 (pesë) ditësh në Gjykatë.

PERMBARUESI GJYQËSOR
BESNIK DOKUSHI

